

AKT – THEMELIMI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
” CONTALDO MEDICAL” SHPK

Sot ne daten 22.07.2024, une i nenshkruari :

CARMINE CONTALDO , i biri i Alfonso, i datelindjes 06.08.1980 , lindur ne Nocera Inferiore (SA), me banim ne Itali , Via della Monica Giuseppe, N.72 Castel, San Giorgio (SA), i pajisur me karten e identitetit italiane CA01068JZ,

Ne baze te ligjit nr.9901 date 14.04.2008 ”Per tregtaret dhe shoqerite tregtare” dhe ligjit nr.9723 date 03.05.2007 ”Per Qendren Kombetare te Regjistrimit”, kam vendosur te themeloj shoqerine me pergjegjesi te kufizuar ” **CONTALDO MEDICAL” SHPK** .

NENI 1

EMERTIMI I SHOQERISE

Shoqeria do te quhet ” **CONTALDO MEDICAL” SHPK** dhe eshte person juridik shqiptar. Veprimtaria e saj rregullohet sipas neneve te ketij statuti dhe Ligjit 9901 date 14.04.2008, si edhe Ligjit per QKR-se .

NENI 2

SELIA E SHOQERISE

Shoqeria do te kete seline e saj ne Durres, Shijak, Xhafzotaj, Nr.Pasurie 19/24, Vol.17, faqe 155, Zona Kadastrale nr.3852.

Shoqeria mund te krijojte filiale, zyra perfaqesimi, ne perputhje me legjislacionin shqiptar.

NENI 3

OBJEKTI I VEPRIMTARISE SE SHOQERISE

Shoqeria do te kete si objekt te veprimtarise se saj:

Klinike mjekesore dhe dentare.

Agjenci imobiliare.

Import eksport.

NENI 4

KAPITALI I SHOQERISE

Kapitali i shoqerise ” **CONTALDO MEDICAL” SHPK** eshte 30.000.000 Leke .

Ky kapital perbehet nga 1 kuote dhe zoterohet ne masen 100% ,nga ortaku i vetem i saj, zoti CARMINE CONTALDO .

NENI 5

KOHEZGJATJA E SHOQERISE

Shoqeria do te zhvilloje veprimtarine e saj per nje periudhe kohore te papercaktuar.



NENI 6 ORGANET E SHOQERISE

- Asambleja e pergjithshme.
- Administratoret.

ASAMBLEJA E PERGJITHSHME

Asambleja e pergjithshme eshte pergjegjese per marrjen e vendimeve per shoqerine per ceshtjet e meposhtme:

- Percaktimin e politikave tregtare te shoqerise.
- Ndryshimin e statutit.
- Emerimin dhe shkarkimin e administratoreve.
- Emerimin dhe shkarkimin e likuiduesve dhe te ekspereve kontabel te autorizuar.
- Percaktimin e shperblimeve per administratorin, likuiduesin dhe ekspertin kontabel.
- Mbikqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret, perfshire pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise.
- Zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit.
- Pjestimin e kuotave dhe anulimin e tyre.
- Perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve.
- Riorganizimin dhe prishjen e shoqerise.
- Miratimin e rregullave proceduriale te mbledhjeve te asamblese.
- Çeshtje te tjera te parashikuara nga ligji apo statuti.

ADMINISTRATORET

Administrator i shoqerise do te jete zoti CARMINE CONTALDO, i biri i Alfonso, i datelindjes 06.08.1980, lindur ne Nocera Inferiore (SA), me banim ne Itali, Via della Monica Giuseppe, N.72 Castel, San Giorgio (SA), i pajisur me karten e identitetit italiane CA01068JZ, i cili emerohet per nje periudhe 5-vjeçare, me te drejte riparteritje te ketij afati.

Administratori mund te shkarkohet ne çdo moment nga asambleja, me shumicë të thjeshte te votave, me kusht që në mbledhje të marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30% të kuotave.

Statuti apo marreveshje te tjera nuk mund te perjashtojne apo kufizojne kete te drejte.

NENI 7

Shpërndarja e fitimit vjetor të shoqërisë

Pjesa e fitimit që i takon secilit ortak nga vlera e fitimit vjetor të deklaruar në pasqyrat financiare të shoqërisë, vendoset të shpërndahet nga asambleja e përgjithshme.

Asambleja e Përgjithshme ka kompetencë t'u shpërndajë ortakëve pjesën e fitimit në raport me vlerën e kapitalit të regjistruar, që kuotat e secilit ortak përfaqësojnë.

Po ashtu, Asambleja e Përgjithshme mund të vendosë që një pjesë e fitimit vjetor të mos u shpërndahet ortakëve, por këto shuma të përdoren për zmadhimin e kapitalit fillestar apo për qëllime të tjera, të cilat ajo i konsideron të dobishme për shoqërinë.

NENI 8

Prishja e shoqërisë.

Prishja e shoqërisë

Shoqëria priset :

- a) kur mbaron kohezgjatja e parashikuar në themelimin e saj,
- b) me vendim të asamblese së përgjithshme,
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit,
- ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723 datë 3.5.2007 për "QKR",
- d) me vendim të gjykatës,
- dh) për arsye të tjera, të parashikuara në statut.

NENI 9

Likuidimi i shoqërisë.

Në rast të likuidimit të shoqërisë, Asambleja e Përgjithshme emëron një likuidator, i cili administron shoqërinë deri në mbylljen e procesit të likuidimit.

Me vendimin e posaçëm të Asamblesë së Përgjithshme, të marrë me shumicë të kualifikuar, pasi janë shlyer detyrimet ligjore ndaj kreditorëve të shoqërisë, likuidatori shpërndan pjesën e mbetur të pasurisë së shoqërisë ndërmjet ortakëve. Kjo shpërndarje e fundit bëhet në raport me vlerën e kapitalit të regjistruar, që kuotat e secilit ortak përfaqësojnë.

Likuiduesit duhet të ftojnë kreditorët për të depozituar pretendimet e tyre për prishjen e saj. Shoqëria e publikon dy herë këtë njoftim, me një interval prej 30 ditësh, në faqen e saj të internetit, si dhe në faqen e internetit të Qendrës

Kombëtare të Biznesit. Në njoftim duhet deklaruar se pretendimet duhet të depozitohen brenda 30 ditëve nga data e njoftimit të fundit.

NENI 10

Përfundimi i likuidimit

Pas shpërndarjes së aktiveve të mbetura, likuiduesi e njofton Qendrën Kombëtare të Biznesit për përfundimin e likuidimit dhe kërkon çregjistrimin e shoqërisë

Veprimtaria e likuiduesit nuk mund të kundërshtohet pas çregjistrimit të shoqërisë nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit.

ORTAKU THEMELUES I SHOQËRISE

" CONTALDO MEDICAL" SHPK

CARMINE CONTALDO

